

URDHËR
Nr. 238, datë 4.6.2021

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME
PATOGENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E
GREQISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, informacioni i marrë nga faqja zyrtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Shëndetit të Kafshëve (OIE), si dhe bazuar në Kodin Shëndetësor të Kafshëve të Tokës dhe Ujit të OIE-së,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga territori i shtetit të Greqisë për ndarjen administrative Maqedoni dhe Trake specifikisht për rajonet Imathia, Thassaloniki, Pella, Kilkis, Pieri, Serres, Chalkidiki, Thasos, Kavala, Drama, Xanthi, Rhohdope dhe Evros; ndarja administrative Epir dhe Maqedonia Perëndimore specifikisht rajonet Thesprotia, Ioannina, Arta, Preveza, Florina, Grevena, Kastori dhe Kozan, për:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër;
- b) zogjtë 24-orësh;
- c) shpendë dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezët e shpendëve;
- dh) mishi i shpendëve;
- e) nënproduktet e shpendëve.

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër, zogjtë 24-orësh, shpendë dekorativë, materialit biologjik, vezët e shpendëve, mishi i shpendëve dhe nënproduktet e shpendëve që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi